



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:097987

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697441

KPPP.nr. 200/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Mitrovicë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër debitorit Onur Firinciogullari me numër të regjistrimit të biznesit 811289994 dhe me seli Në Mitrovicë, Rr. “Mbretresha Teutë”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Petrit Lladrovci, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 1590/2022 të datës 08.11.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datë 16.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Onur Firinciogullari, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 1590/2022 i datës 08.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Atip Mustafa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Mitrovicë – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në bazë të dokumentit përbarues – Vendimit 02 Nr.22-135/2021C i datës 24.11.2021 ka caktuar zbatimin e përbarimit përmes urdhrit përbarimor P.nr. 1590/2022 të datës 08.11.2022 ndaj debitorit Onur Firinciogullari, të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 10,700.00 EUR (dhjetëmijë e shtatëqind), me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrit për lejimin e përbarimit nga ana e përbaruesit, andaj i ka

propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi prapësimin e debitorit dhe ta anuloj Urdhrin Përmbarrimor P.nr.1590/22 të datës 08.11.2022 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Atip Mustafa.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Vendimin Nr. 22-135/2021C të datës 24.11.2021, në bazë të së cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se Vendimi Nr. 22-135/2021C i datës 24.11.2021, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri”*, ngase aktvendimi i lartcekur është i pajisur me klauzolën e përmbarrueshmërisë nga e cila rezulton se i njëjti është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 23.09.2022.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarrues, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigoroze formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit

të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 200/24, datë 16.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.